

Berat, më16/12/2025



Ky raport teknik paraprak është krijuar nga projekti MandaGREEN, mbështetur nga GreenAL i cili zbatohet nga Co-PLAN, COSV dhe VIS Albania. Pikëpamjet dhe përfundimet e përfshira këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmëri ato të Qeverisë Suedeze ose të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim për Zhvillim (Sida).

RAPORT TEKNIK (Paraprak)

1. Hyrje

Ky raport teknik përgatitet për të përshkruar gjendjen aktuale, ciklin agronomik dhe praktikën e ndjekur në parcelën me mandarina ekzistuese të mbështetur nga GreenAL në përkatesinë e Z Muharrem SULA- fermer në DIMAL, Qarku Berat, si pjesë e projektit Nr 16510 G03 “MandaGREEN”, të organizatës “Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore” Berat, mbështetur nga GreenAL.

Qellimi i këtij raporti është evidentimi i masave teknike të zbatuara, identifikimi i problematikave dhe propozimi i përmirësimeve për rritjen e prodhimtarisë dhe cilësisë së Mandarinave, si dhe nxjerrja në pah e praktikave më të mira të realizuara në këtë plantacion.

2. Përshkrimi i parcelave

Parcelat e kultivuara me mandarina ndodhen në zonë me klimë tipike mesdhetare, të përshtatshme për këtë kulturë. Sipërfaqja mesatare e një parcele varion nga 0.5 deri në 2 ha, me tokë të lehtë argjilore dhe me sistem vaditjeje të instaluar pjesërisht. Në shumicën e rasteve, mbjelljet janë 5–8 vjeçare dhe në fazë prodhimi aktiv. Në kuadër të projektit tonë, sipërfaqja e monitoruar nga Stafi i organizatës është 1 dynym.

3. Cikli agronomik i mandarinës

Kalendari i shërbimeve agroteknike në mandarinë

Muajt	Shërbimet agroteknike në mandarinë
Janar	Plehrimi bazë punimi i tokës, frezim, marrëmbajtje rrethi kullos dhe si ujë, rigurimi nëse ka dëmtime dezinfektimi i rrugëve me pastë bordeaux 5%.
Shkurt	Vjelja, Rrjeti ujër dhe si kullos, spërkate, mbjellje të fidanëve, vazhdojnë punimet e tokës.
Mars	Vjelja, Shërbimet e kulturës, spërkate, ujë, prashitje, krasitja, mbjellje të reja, plehrimi suplementar para prashitjes.
Prill	Shërbimet, krasitja, ujë, spërkate, mbjellja.
Maj	Shërbimet, spërkate, ujë, mbjellje, plehrim azotik, prashitje, frezim, ujë.
Qershor	Shërbimet, spërkate, ujë, mbjellje, prashitje e frezim.
Korrik	Prashitjet, ujë, spërkate, mbjellje, vazhdon spërkate gëthore me plehra të kombinuara.
Gusht	Prashitjet, ujë, spërkate, mbjellje, shërbimet, krasitje verore, dezinfektimi i gëthorëve me pastë bordeaux 5%.
Shtator	Shërbimet, ujë, spërkate, punimi i dytë i tokës, para punimit shpërndahen plehra organik dhe minerale, frezim.
Tetor	Sigurohen arkat, gëthoret, shkakëlet për vjeljen.
Novator	Shërbimet, vjelja, spërkate, kontrollimi i funksionimit i rrjetit kullos.
Dhjetor	Vjelja.
	Fundi i Vjeljes.

Cikli vjetor i kultivimit të mandarinës përfshin disa faza të ndërlidhura që sigurojnë zhvillimin e bimës dhe cilësinë e frutit. Fazat e shërbimeve agroteknike si më poshtë vijojnë, janë respektuar me korrektësi nga ky fermer:

- **Krasitja:** është zhvilluar në periudhën janar–shkurt për të rregulluar strukturën e kurorës dhe për të përmirësuar ndriçimin e degëve.
- **Plehrimi:** është aplikuar para lulëzimit (mars–prill) dhe pas vjeljes, me përdorim të plehrave organike dhe kimike bazuar në përvojën e fermerit dhe jo sipas analizës së tokës.
- **Ujitja:** është kryer gjatë periudhës prill–shtator, me sistem pika-pikë, në varësi të reshjeve dhe temperaturës.
- **Lulëzimi dhe frutifikimi:** periudha kritike është prill–maj, ku nevojitet kujdes ndaj sëmundjeve dhe insekteve. Këtu janë përdorur pesticide të certifikuara, nën kujdesin e agronomit, gjë e cila siguron një garanci të rëndësishme për sigurinë ushqimore të produktit.- Lloji i pesticidit: **Muligan 100 ml (pyriproxyfen)**, arsyeja ishte: luftimi i breshkës së agrumeve. Kjo spërkate është bërë në datën 30 Gusht 2025.

- **Vjelja:** ka filluar në muajin nëntor për disa arësye; zakonisht ndodh në periudhën tetor–dhjetor, kur fruti ka arritur pjekurinë fiziologjike dhe ngjyrën karakteristike. Por, problematika mbi sigurinë ushqimore vitin e kaluar, ka tronditur tregjet e blerjes së frutit dhe reputacionin e fermerëve të DIMALIT në Berat.

4. Praktikrat e ndjekura (Praktika pozitive)

- Në parcelën e Z Muharrem SULA është zbatuar me rigorozitet praktika tradicionale e kultivimit si:
- ***Punimi i tokës, plehërimi bazë, kontrolli i barërave të këqija dhe përdorimi i pesticideve në raste të nevojshme, duke respektuar dozat dhe rekomandimet e agronomit.***
- ***Pesticidet janë përdorur vetëm kur janë këshilluar nga specialisti, dhe pas periudhës së vjeljes (në kohën e duhur), duke përdorur sasinë dhe produktin e duhur, për të mos patur ndikim në tokë, ujë, ajër, bimë.***
- ***Gjithashtu është përdorur në rritje pleh organik dhe metoda më të qendrueshme të vaditjes me pika.***

5. Problematikat e evidentuara

- Disa parcela kanë tokë me nivel të ulët organik dhe kërkojnë përmirësim me plehra natyrale. Kjo nuk është konstatuar me analiza kimike, por jemi bazuar në ngjyrën e tokës, përvojën e fermerit, madhësinë e kokrrës dhe ngjyrën e produktit (mandarinës).

Si problematika mund të vëmë në pah

- Mungesë e analizave periodike të tokës dhe ujit.
- Në disa zona, sistemi i ujitjes është i dëmtuar ose jo efikas.
- Mungesë e mekanizimit në disa faza të punës.
- Përdorim i kufizuar i praktikave ekologjike dhe metodave të integruara të menaxhimit të dëmtuesve.

- Hedhje e qeskave të përdorura në Parcelë, dhe jo në koshat e plehrave, gjë që çon në **ndotje të Tokës, ujit, ajrit, pra të mjedisit.**

6. Rekomandime teknike

- Kryerja e analizave të rregullta të tokës dhe përshtatja e plehërimit sipas rezultateve.
- Zëvendësimi gradual i plehrave kimike me plehra organike.
- Rritje e largësisë së fidanëve, për të ulur kontaminimin e bimëve me nj-tjetrën, për një kurorë të ajrosur plotësisht.
- Riparimi dhe modernizimi i sistemit të ujitjes për kursimin e ujit.
- Përdorimi i metodave biologjike për kontrollin e dëmtuesve.

- 